

## **E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE**

### **PROGRAM MËSIMOR I LËNDËS (“SYLLABUS”)**

### **SEMESTRI VJESHTOR - VITI 2025**

*Profesori:* Dr. Qerim Qerimi

*Orët e ligjëratave:* E hënë: 09:15 – 11:30 (Amfiteatri i Vogël) & E hënë: 12:00 – 14:15 (Amfiteatri i Vogël)

*Orët e konsultimeve:* E hënë: pas orëve të ligjëratave dhe me paracaktim

E-mail: [qerim.qerimi@uni-pr.edu](mailto:qerim.qerimi@uni-pr.edu)

#### **Teksti bazë:**

ZEJNULLAH GRUDA, E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE (2013).  
MATERIALE SHITESË TË PËRGATITURA NGA PROFESORI I LËNDËS

#### **Literatura shtesë (tekstet e rekomanduara):**

ENVER HASANI, TEMA TË ZGJEDHURA NGA E DREJTA DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE (2016)

QERIM QERIMI, REMZLJE ISTREFI & FLAKRON SYLEJMANI, PËRMBLEDHJE E MARRËVESHJEVE DHE INSTRUMENTEVE LIGJORE NDËRKOMBËTARE (2016)

WILLIAM R. SLOMANSON, PIKËPAMJE THEMELORE MBI TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE (2006) (PJESË – RASTE TË PËRKTHYERA NË SHQIP).

W. MICHAEL REISMAN, MAHNOUSH ARSANJANI, SIEGFRIED WIESSNER & GAYL S. WESTERMAN, INTERNATIONAL LAW IN CONTEMPORARY PERSPECTIVE (CASEBOOK, FOUNDATION PRESS, 2004)

IAN BROWNLIE, PRINCIPLES OF PUBLIC INTERNATIONAL LAW (7TH ED. 2008)

PETER MALANCZUK, AKEHURST’S PUBLIC INTERNATIONAL LAW (7TH ED. 1997)

SIR ROBERT JENNINGS & SIR ARTHUR WATTS (EDS.), OPPENHEIM’S INTERNATIONAL LAW, VOLUME I: PEACE, (9<sup>TH</sup> ED. 1992)

SEAN D. MURPHY, PRINCIPLES OF INTERNATIONAL LAW (2006).

CHRISTIAN TOMUSCHAT AND JEAN-MARC THOUVENIN (EDS.), THE FUNDAMENTAL RULES OF THE INTERNATIONAL LEGAL ORDER: *JUS COGENS* AND OBLIGATIONS *ERGA OMNES* (2006).

#### **PËRSHKRIMI I LËNDËS:**

Kjo lëndë ka për qëllim parësor që të ofrojë një studim të autoritetit në proceset e vendimmarrjes në komunitetin botëror, duke përfshirë si procesin konstitutiv themelor me të cilin e drejta ndërkombëtare krijohet dhe aplikohet, ashtu dhe rendin publik që themelohet si rezultat i këtij procesi.

Konsideratë e veçantë do t'i jepet si përcaktimit formal ashtu dhe praktikës efektive të pjesëmarrësve në proceset e vendimmarrjes në arenat e jashtme (siç janë

shtetet-kombe, organizatat qeveritare, ndër-qeveritare dhe jo-qeveritare, korporatat shumëkombëshe, si dhe bashkimet apo asociacionet private dhe individët), perspektivave të tyre, arenave të ndërveprimit, bazës së pushtetit (kontrolli mbi njerëzit, burimet apo resurset planetare dhe institucionet), dhe strategjive të aplikuara (si p.sh., përdorimi i instrumentit diplomatik, ideologjik, ekonomik dhe ushtarak).

Theksi kryesor, pra, do të vihet në procesin dhe dinamikat e procesit të krijimit ose gjenerimit, ndryshimit apo modifikimit dhe shfuqizimit të *ligjeve* ndërkombëtare, ose me fjalë tjera, mënyrës së *operimit* të së drejtës në arenat e jashtme. Burimet e të drejtës ndërkombëtare, teoritë rreth saj, dhe rastet e ndryshme të vendosura nga trupat gjyqësor në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare kanë rëndësi thelbësore për të kuptuar këtë proces. Dhe ato do të studiohen.

Përqendrimi tjetër me rëndësi i lëndës do të jetë në shqyrtimin dhe studimin e rolit të shteteve, krijimin e tyre, transformimin dhe shuarjen së ekzistuarit të tyre. Njohja, suksedimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare janë aspekte të tjera të rëndësisë themelore për studimin dhe kuptimin e të drejtës ndërkombëtare. Një sërë temash të tjera aktuale të së drejtës ndërkombëtare publike do të jenë subjekt shqyrtimi, gjithashtu.

### **VLERËSIMI:**

Do të ketë një provim përfundimtar—pjesa kryesore e vlerësimit—që do të mbulojë, përveç nëse u thuhet ndryshe, materialet e detyrueshme për lexim, si shtesë e asaj që është thënë në ligjërata dhe ushtrime. Nota juaj do të varet në vlerën prej 60 për qind (%) nga ky provim.

Do të ketë edhe një vlerësim në mes të semestrit, për testimin e dijes në çështjet e studiuara deri në atë kohë, që do të përbëjë 30 % të vlerësimit të përgjithshëm.

Pjesa e mbetur, prej 10 %, do të përcaktohet mbi bazën e pjesëmarrjes së rregullt dhe përmbajtjesore në ligjërata. Paraqitur në një formë tjetër, komponentët e vlerësimit dhe vlera e tyre përkatëse është si në vijim:

- **Provimi mes-semestral: 30 për qind (%)**
- **Provimi përfundimtar: 60 për qind (%)**
- **Pjesëmarrja aktive dhe e rregullt në ligjërata dhe ushtrime: 10 për qind (%)**

Do të ketë një politikë rigorozë në përcaktimin e vijueshmërisë së lëndës dhe çfarëdo mungese, e jo më tepër se tri, do të trajtohet me kujdes të shtuar.

Rezultati përfundimtar do të përcaktohet nga rezultati i akumuluar në dy testet e organizuara gjatë semestrit (mes-semestral dhe përfundimtar) dhe vijueshmëria në ligjërata.

Si shtesë e metodës së vlerësimit të shpallur si më sipër, pjesëmarrja cilësore ose përmbajtjesore në diskutimet gjatë ligjëratave dhe/ose ushtrimeve mund të vlerësohet edhe me 10 për qind (%) të tjerë. Nëse pjesëmarrja, në cilësi dhe përmbajtje, është e mjaftueshme për të marrë këtë përqindje, vendimi përfundimtar për të përcaktuar këtë i takon profesorit të lëndës.

Me përqindje të njëjtë, në varësi të kohës në dispozicion dhe dinamikës së procesit mësimor, studentët kanë mundësinë e zgjedhjes ndërmjet dy opsioneve fakultative në vijim, të cilat pra nuk janë detyruese: (1) një prezantim gojor dhe mbrojtjen e të njëjtit

përpara studentëve (kryesisht në orët e ushtrimeve), për jo më pak se 15 minuta, lidhur me një çështje të trajtuar në këtë lëndë dhe për një temë që do të përcaktohet në konsultim me profesorin ose asistentin e lëndës, ose (2) shkrimi dhe dorëzimi i një punimi për një çështje që ka të bëjë me të drejtën ndërkombëtare (shih Shtojcën I për një listë temash të mundshme). Për nga aspekti i formës, punimi pritet të ketë nga rreth 10 deri në jo më shumë se 20 faqe të kompjuterit, *single-spaced*, formati 12 *Times New Roman* (shih Shtojcën II për disa rregulla-udhëzime të përgjithshme të shkrimit). Për sa i përket përmbajtjes, qëllimi është përdorimi i teknikave të përshtatshme të jurisprudencës për të analizuar dhe rekomanduar zgjidhje të problemeve ligjore ose shoqërore në fushën ndërkombëtare. Punimet në këtë format duhet të paraqesin (1) faktet e problemit në mënyrë të detajuar, të qartë dhe të saktë, (2) të përshkruajnë qëndrimet e kundërta të palëve të përfshira në rast ose kontest, (3) të pasqyrojnë trendët në vendimet autoritative dhe të kontrolluara (në nivel vendor dhe ndërkombëtar, traktatet, praktikën e shteteve të pranuar si ligj, rastet, ligjet kombëtare, etj.) dhe të analizojnë faktorët që i kushtëzojnë këto vendime (faktorët kushtëzues), (4) të ofrojnë një pasqyrë të kaheve të proceseve vendimmarrëse, dhe (5) të rekomandojnë zgjidhje ose alternativa ndaj problemit të trajtuar me një qëllim që do të kontribuonte drejt një rendi publik global në dinjitet.

Kur zgjidhni temën dhe shkruani punimin, kujdes i veçantë i duhet kushtuar mënyrës së të shkruarit të cilës shumë studentë po i qasen, duke përdorur gjithnjë e më shumë Inteligjencën Artificiale (IA) si mjet hulumtimi dhe shkrimi. Në këtë kontekst, kërkesa është që IA të përdoret në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente. IA mund të mbështesë studentët, por nuk mund të zëvendësojë mendimin e pavarur kritik dhe idetë origjinale që janë thelbësore në një kontekst akademik. Me qëllim të integritetit të IA në proces mësimor në mënyrë konstruktive dhe për të mos komprometuar integritetin akademik, studentët duhet të jenë transparent kurdo që përdorin IA. Si shprehje e kësaj transparence, secili student që përdor IA, duhet të mbajë një shtojcë gjatë procesit të shkrimit në të cilën studenti e përshkruan në mënyrë të qartë dhe të ndershme nëse, si dhe deri në çfarë shkalle ka përdorur mjetet e IA gjatë përgatitjes së propozimit dhe shkrimit të punimit.

Një minimum prej 55 % është i nevojshëm për notë pozitive kaluese.

### **OBJEKTIVAT E LËNDËS:**

Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të:

1. Kuptojnë dhe shpjegojnë strukturën institucionale ndërkombëtare, përfshirë fillat dhe zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare publike;
2. Njohin dhe përdorin burimet e të drejtës ndërkombëtare, si dhe mjetet ndihmëse për përcaktimin e të drejtës në arenën ndërkombëtare;
3. Kuptojnë dhe shpjegojnë rolin e të drejtës në procesin e politikëbërjes ndërkombëtare;
4. Njohin dhe kuptojnë aspekte të veçanta dhe/ose të specializuara të së drejtës ndërkombëtare (siç është krijimi dhe njohja e shteteve, përdorimi i instrumentit ushtarak në të drejtën ndërkombëtare, modalitetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare apo suksedimin në të drejtën ndërkombëtare);
5. Të përfitojnë aftësi dhe shkathtësi analitike, argumentuese dhe kreative përmes analizës dhe diskutimit të rasteve dhe të teksteve ligjore.

## **KORNIZA PËRMBAJTJESORE:**

E Drejta Ndërkombëtare është një lëndë sfiduese pasi operon në një arenë politike që për nga struktura dhe dinamika dallon nga e drejta vendëse me të cilën studentët janë më të familjarizuar. Brenda kufizimeve dhe/ose kornizave të përcaktuara kohore, kjo lëndë do të përfshijë një shumësi temash, disa prej të cilave janë të trajtuara, nga aspekti i të drejtës vendëse, në lëndë të veçanta. Për hir të përgatitjes sa më të mirë dhe të mundësisë për ndërveprim më të madh dhe të dobishëm në klasë, studentët udhëzohen që të lexojnë paraprakisht materialet për temën e cila do të diskutohet në orën(-t) pasuese, për të krijuar një kuptim më të mirë të përmbajtjes së materialit që do të diskutohet në ligjërata. Studentët do të njoftohen rregullisht për materialet që duhen lexuar për orët pasuese. Programi në vijim, po ashtu, ofron një udhëzues të rëndësishëm praktik në këtë drejtim.

## **METODA:**

Metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret në zbatimin e programit të mëposhtëm mbështetet në analizën e thellë të materialeve të përzgjedhura sipas udhëzimit të profesorit të lëndës.

Studentët duhet të ballafaqohen me problemet e jetës së përditshme të hulumtimit dhe interpretimit, të zgjedhura midis atyre më të shpeshta dhe tipike në proceset vendimmarrëse dhe të ligjërjes ndërkombëtare, me përparësi ndaj atyre që kanë ose mund të kenë një ndërlidhje më të përafërt me përvojat dhe nevojat në Kosovë, ose të rrënjësura në kontekstin e Kosovës dhe të atij më të gjerë rajonal.

Studentëve, pra, nuk do t'u prezantohen vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to.

Do të bëhet, gjithashtu, *përpyetje* për një ekuilibrim të përhapjes së njohurisë mbi tiparet kryesore të sistemit institucional ndërkombëtar dhe nocioneve më të specializuara, ndonëse orientimi parësor do të jetë, — i motivuar nga filozofia udhëheqëse në këtë rast, — se njohuria bazë mund të përftohet lehtë si derivat i diskutimit të përqendruar në probleme të specializuara, përparësia e të cilës empirikisht qëndron në një shkallë më të lartë probabiliteti të ngritjes apo rritjes së aftësisë ose shkathtësisë dhe kapacitetit për të zotëruar nocione më specifike dhe për të vepruar në kontekste më praktike.

Dimensioni praktik i lëndës kryesisht do të trajtohet përmes analizës dhe studimit të rasteve të vendosura nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe gjykatat e tribunalet e tjera ndërkombëtare, si dhe gjykatat vendore për çështje me interes të së drejtës ndërkombëtare dhe zbatimit e interpretimit të saj.

## **Shënim:**

Ju lutem vëreni se ky është një *projekt* plan-program dhe mund të ndryshohet, përmirësohet apo përshtatet gjatë zhvillimit të lëndës për qëllime të rezultatit më të mirë.

# ORARI DHE PËRMBAJTJA E LIGJËRATAVE

## Java e Parë:

### **HYRJE**

Përmbajtja e lëndës, metoda, organizimi dhe kërkesat e lëndës

## Java e Dytë:

### **ÇFARË ËSHTË E DREJTA NDËRKOMBËTARE?**

- Historiku i të Drejtës Ndërkombëtare
- Perspektivat kryesore teorike
- Si ta kuptojmë të Drejtën Ndërkombëtare?  
(Aspekte krahasuese: E drejta e brendshme dhe e drejta ndërkombëtare)
- Pse shtetet i binden të Drejtës Ndërkombëtare?

*Gruda, fq. 3-18;  
Material shtesë.*

## Java e Tretë:

### **BURIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE, KODIFIKIMI DHE ZHVILLIMI PROGRESIV I: TRAKTATET DHE ZAKONET NDËRKOMBËTARE**

- Kuptimi dhe klasifikimi i burimeve të së drejtës ndërkombëtare
- Traktatet ndërkombëtare (llojet; hyrja në fuqi; plotësimi dhe ndryshimi; shfuqizimi; rezervat dhe deklaratat; interpretimi i traktateve dhe llojet e interpretimit)
- Pozita e traktateve ndërkombëtare në rendin juridik të Kosovës
- Procesi i krijimit të së drejtës ndërkombëtare zakonore
- Marrëdhënia ndërmjet të drejtës zakonore dhe traktateve ndërkombëtare, si dhe burimeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare

*Gruda, fq. 54-60; shih, gjithashtu, fq. 287-344 (për traktatet);  
Material shtesë për Burimet e të Drejtës Ndërkombëtare.*

## Java e Katërt:

### **BURIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE, KODIFIKIMI DHE ZHVILLIMI PROGRESIV II: PARIMET E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE MJETET NDIHMËSE (DOKTRINA DHE VENDIMET GJYQËSORE) & BURIMET TJERA TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE HIERARKIA E NORMAVE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE**

- Rezolutat dhe deklaratat e organizatave ndërkombëtare dhe aktet e njëanshme (unilaterale) si burim i të Drejtës Ndërkombëtare; “e drejta e butë” (*soft law*)
- Normat *jus cogens*, detyrimet *erga omnes*, neni 103 i Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe marrëdhëniet midis tyre
- Fenomeni i “fragmentimit” të së Drejtës Ndërkombëtare
- Kodifikimi dhe zhvillimi progresiv i të Drejtës Ndërkombëtare; Komisioni i të Drejtës Ndërkombëtare; temat aktuale të shqyrtuara nga Komisioni i të Drejtës Ndërkombëtare

*Gruda, fq. 60-68 dhe fq. 245-248; Material shtesë.*

## Java e Pestë:

### **SUBJEKTET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE**

- Kuptimi dhe natyra e subjekteve në të drejtën ndërkombëtare
- Shteti si subjekt i të drejtës ndërkombëtare
- Përgjegjësia e shteteve në të drejtën ndërkombëtare
- Organizatat ndërkombëtare (ndërqeveritare dhe joqeveritare)
- Kuptimi, llojet dhe përgjegjësia e organizatave ndërkombëtare
- Pozita e individit në të drejtën ndërkombëtare
- Pakicat, popujt indigjenë, lëvizjet çlirimtare
- Korporatat shumëkombëshe
- Ushtritë private, grupet terroriste dhe grupet e tjera të organizuara

*Gruda, fq. 69-77; 136-157; 345-416; 435-440.*

## Java e Gjashtë:

### **E DREJTA NDËRKOMBËTARE NË VEPRIM**

- Analizë dhe studim i mendimit këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në rastin: *Pajtueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Deklaratës së Njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën*; dhe aktgjykimit në rastin e Aplikimit të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit (*Bosnjë dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi*)
- Përmbajtja, kuptimi dhe implikimet për të Drejtën Ndërkombëtare të mendimit këshillëdhënës në lidhje me ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës dhe aktgjykimit në lidhje me Aplikimin e Konventës së Gjenocidit

*Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë; Përmbledhje e përkthyer në gjuhën shqipe e Rastit të Gjenocidit.*

## Java e Shtatë:

### **PREZANTIME: ÇËSHTJE AKTUALE TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE**

#### ***Tema të mundshme:***

- Konventa Kornizë për Inteligjencën Artificiale dhe të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit: Përmbajtja dhe efektet
- E Drejta Ndërkombëtare dhe ndryshimet klimatike
- Mendimi këshillëdhënës i GJND-së në lidhje me detyrimet e shteteve për ndryshimet klimatare
- Gaza dhe E Drejta Ndërkombëtare
- Invazioni i Rusisë në Ukrainë dhe E Drejta Ndërkombëtare
- Reagimi i organeve të Kombeve të Bashkuara pas invazionit të Rusisë në Ukrainë
- Juridiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në *rastin e Gjenocidit në Mianmar* (Gambia kundër Mianmarit)
- Reagimi i institucioneve ndërkombëtare ndaj pandemisë COVID-19
- *Përgjegjësia për të mbrojtur* në të Drejtën Ndërkombëtare
- Ndërhyrja ushtarake në Libi
- Rasti i Sirisë
- Rasti i aneksimit të Krimesë
- E Drejta Ndërkombëtare dhe Interneti
- Deklarata e Pavarësisë së Katalonisë dhe e Drejta Ndërkombëtare
- Bllokada e Katarit dhe ligjshmëria e saj sipas të drejtës ndërkombëtare

- Njohja nga SHBA-të e Jerusalemit si kryeqytet i Izraelit
- Miratimi i tekstit përfundimtar të Traktatit për Ndalimin e Armëve Bërthamore (2017)
- Mendimi këshillëdhëns i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në rastin e *Ishujve Chagos*

### **Java e Tetë:**

## **TESTI MES-SEMESTRAL**

### **Java e Nëntë:**

#### **NDËRVEPRIMI NË MES TË AKTORËVE VENDËS DHE NDËRKOMBËTAR NË APLIKIMIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE**

- Teoria moniste
- Teoria dualiste
- Sistemi i “përzier” monist – dualist
- Praktika krahasimtare e shteteve
- Statusi i të Drejtës Ndërkombëtare në rendin juridik të Kosovës
- Roli i institucioneve të ndryshme në aplikimin dhe interpretimin e të drejtës ndërkombëtare

*Gruda, fq. 19-23; Kushtetuta; raste gjyqësore.*

### **Java e Dhjetë:**

#### **KRIJIMI, TRANSFORMIMI DHE PUSHIMI SË EKZISTUARI I SHTETEVE: E DREJTA PËR VETËVENDOSJE**

- Koncepti i shtetit
- Lindja e shteteve
- E drejta për vetëvendosje
- Zhdukja e shteteve; “vdekja” e shteteve
- Të drejtat dhe detyrimet e shteteve
- Llojet e shteteve

*Gruda, fq. 69-77 dhe 99-135; Hasani, fq. 41-77 & 225-230.*

### **Java e Njëmbëdhjetë:**

#### **SHTETI, NJOHJA E SHTETEVE DHE QEVERIVE, NDRYSHIMI I REGJIMEVE**

- Kuptimi dhe rëndësia e njohjes
- Llojet e njohjes
- Njohja e Qeverisë dhe Kryetarit të Shtetit
- Njohja e kryengritësve si palë ndërluftuese
- Detyrimi për mosnjohje
- Kosova në teorinë dhe praktikën e njohjes

*Gruda, fq. 78-91.*

### **Java e Dymbëdhjetë:**

#### **SUKSEDIMI NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE**

- Kuptimi i suksedimit
- Suksedimi dhe traktatet
- Suksedimi dhe borxhet publike
- Suksedimi dhe prona publike
- Suksedimi dhe arkivat si dhe dokumentet tjera
- Suksedimi dhe shtetësia
- Suksedimi dhe të drejtat e fituara

*Gruda, fq. 92-98; 99-120; Hasani, 77-120.*

### **Java e Trembëdhjetë:**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE**

- Mjetet *ekstra* juridike të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërkombëtare (mjetet diplomatike): negociatat; shërbimet e mira; ndërmjetësimi; hetimet; pajtimi
- Mjetet gjyqësore (Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe gjykatat e tjera ndërkombëtare; Arbitrazhi)
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të Organizatave Ndërkombëtare

*Gruda, fq. 475-519 dhe 520-523.*

### **Java e Katërbëdhjetë:**

#### **PËRDORIMI I INSTRUMENTIT USHTARAK (*JUS AD BELLUM*) DHE E DREJTA HUMANITARE (*JUS IN BELLO*)**

- Rregullimi i përdorimit të forcës në të drejtën ndërkombëtare: Nga Lidhja e Kombeve deri te Kombet e Bashkuara
- Aspektet konceptuale të luftës
- Vetëmbrojtja individuale dhe kolektive
- Autorizimi i përdorimit të forcës nga KS i OKB-së
- Ndërhyrja humanitare
- Burimet e të drejtës ndërkombëtare të luftës
- Fillimi dhe efektet e konfliktit të armatosur
- Palët në konflikt të armatosur
- Teatri i luftës; armët, mjetet dhe metodat e ndaluara në konflikt të armatosur
- Personat e mbrojtur në konflikte të armatosura
- Objektet e mbrojtura në konflikte të armatosura
- Përfundimi i konfliktit të armatosur

*Gruda, fq. 525-599.*

### **Java e Pesëmbëdhjetë:**

#### **TESTI PËRFUNDIMTAR**

## **SHTOJCA I: TEMA TË MUNDSHME PËR PUNIME**

### **A. Karakteristikat e rendit të sotëm ligjor ndërkombëtar dhe hierarkia e normave**

1. Rendi ligjor ndërkombëtar si rend autonom
2. Marrëdhëniet ndërmjet rendeve ligjore
3. Krijimi i *normave* ndërkombëtare
4. Marrëdhëniet midis normave *jus cogens* dhe detyrimeve *erga omnes*
5. Normat e krijuara në mënyrë spontane
6. Manifestimet e ndryshme të vullnetit me efekte të papërcaktuara (“ligji i butë”)
7. Identifikimi i të drejtës ndërkombëtare zakonore
8. Parimet e përgjithshme të së drejtës: përmbajtja dhe statusi
9. Hierarkia e normave
10. “Fragmentimi” i të drejtës ndërkombëtare
11. Ndryshueshmëria e rolit të Këshillit të Sigurimit

### **B. E Drejta Ndërkombëtare dhe Shëndeti Publik Botëror**

1. E Drejta Ndërkombëtare dhe COVID-19
2. Reagimi i institucioneve ndërkombëtare ndaj pandemisë COVID-19
3. Kombet e Bashkuara dhe COVID-19
4. Roli i Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe agjencive të tjera të specializuara

### **C. E Drejta Ndërkombëtare dhe Ndryshimet Klimatike**

1. Protokollin e Kjosës
2. Marrëveshja e Parisit për Klimën

### **D. Lufta Globale kundër Terrorizmit**

1. Statusi ligjor i terroristëve
2. Përgjegjësia e shteteve për veprimet e grupeve terroriste
3. 11 Shtatori dhe Reagimi i Kombeve të Bashkuara
4. Trajtimi i të burgosurve si terroristë të dyshuar dhe e drejta e aplikueshme humanitare dhe të drejtat e njeriut

### **E. E Drejta Ndërkombëtare dhe Invadimi i Irakut & Posedimi dhe përdorimi i armëve për shkatërrim në masë**

1. Ligjshmëria e përdorimit të forcës kundër Irakut
2. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1441
3. Regjimi i sanksioneve ekonomike
4. Limitet e posedimit të armëve për shkatërrim në masë
5. Ligjshmëria e përdorimit të armëve për shkatërrim në masë

### **F. E Drejta Ndërkombëtare dhe Shkelja e të Drejtave të Njeriut**

1. Normat imperative të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare (*jus cogens*)
2. Krimet kundër njerëzimit
3. *Pastrimi etnik* në të drejtën ndërkombëtare

4. Kosova, Timori Lindor dhe e drejta për vetëvendosje
5. Ndërhyrja humanitare në Haiti, Kosovë dhe Timor Lindor
6. Amnestitë dhe komisionet e të vërtetës
7. Juridiksioni i Gjykatës Penale Ndërkombëtare
8. Ekstradimi dhe gjykimi i kriminelëve ndërkombëtar: Mësimet nga *Pinochet*
9. Rasti i Sadam Huseinit

#### **G. Tema tjera të mundshme**

1. Sovraniteti territorial dhe shkëputja (*secesioni*)
2. Vetëvendosja e popujve
3. Të drejtat e pakicave
4. E drejta e mjedisit
5. Mbrojtja e mjedisit përmes gjykatave
6. E drejta e biznesit dhe tregtisë ndërkombëtare
7. Luftërat tregtare: siguria kombëtare dhe Organizata Botërore e Tregtisë
8. E drejta e teknologjive bashkëkohore të komunikimit, përfshirë internetin

### **SHTOJCA II: RREGULLA – UDHËZIME TË PËRGJITHSHME SHKRIMI**

Këtu janë disa sugjerime rreth shkrimit të punimeve. Ju lutemi lexojini këto përpara se të shkruani punimin, nëse e keni zgjedhur opsionin e shkrimit të një punimi.

1. **Bëjeni të qartë tezën kryesore të punimit tuaj** në fillim të punimit ose në pjesën hyrëse, e preferuar në paragrafin e parë;
2. **Qëndroni të përqendruar (*konsistent*)** – ajo që paraqitet në fillim të punimit duhet të ketë lidhmëni me gjetjet e paraqitura në fund të punimit.
3. **Shmangini përgjithësimet;**
4. **Shkruani qartë**, duke shmangur fjalitë dhe paragrafët e gjatë;
5. **Mbështetini pohimet apo deklaratimet tuaja** me referenca përkatëse;
6. Pas përfundimit të punimit, **ri-lexojeni dhe redaktojeni** atë;
7. **Mos bëni plagjiaturë.** Plagjiatura shprehet në dy forma, të dyja të palejueshme. *Së pari*, plagjiaturë bëni nëse i përdorni fjalët e një burimi pa e futur atë në thonjëza. Nëse përdorni fjalë nga një burim, atëherë duhet ta vendosni në thonjëza, dhe jo vetëm ta citoni në fusnotë. *Së dyti*, plagjiaturë bëni edhe nëse e merrni idenë ose idetë nga një burim, pa e cituar burimin në fusnotë. *Sanksionimi për plagjiaturë* varet nga shkalla e plagjiaturës, dhe mund të konsistojë nga një notë më e ulët deri te mohimi i të drejtës për ta kaluar provimin në afatin përkatës.
8. Çfarëdo **përdorimi i mundshëm i Inteligjencës Artificiale duhet bërë në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente**, përdorim ky i cili nuk mund të zëvendësojë mendimin e pavarur kritik dhe idetë origjinale.